

## Eurofjalori

**Acquis communautaire** nënkupton bazën ligjore të Bashkimit Evropian, e cila është në ndryshim të vazhdueshëm. Ajo përfshin parimet dhe objektivat politike të traktateve; legjislacionin e përshtatur në zbatim të tyre si dhe jurisprudencën e Gjykatës së drejtësisë; deklaratat dhe rezolutat e miratuara në kuadrin e Bashkimit Evropian; aktet e ndryshme të miratuara në fushën e drejtësisë, çështjeve të brendshme, politikës së jashtme dhe të sigurisë; marrëveshjet ndërkombëtare të BE-se si dhe marrëveshjet e lidhura midis vetë vendeve anëtare në fushat e veprimtarisë së BE-së. Pranimi i "acquis communautaire" nga vendet anëtare është parakusht për aderimin e tyre në BE. Kjo gjë nënkupton përshtatjen e legjislacioneve kombëtare me normat e KE-së dhe zbatimin e tyre që në momentin e aderimit.

**Akti Unik Evropian (AUE)** u nënshkrua në Luksemburg dhe u ratifikua nga parlamentet e vendeve anëtare në 1986. Ai hyri në fuqi në 1 korrik 1987. Rëndësia e këtij dokumenti qëndron në faktin se ai preku një sërë çështjesh të rëndësishme: ai dha dinamizëm ngrehinës evropiane nëpërmjet krijimit të tregut të brendshëm më 1 janar 1993. Akti Unik pati gjithashtu rëndësi në forcimin e rolit të Parlamentit evropian, duke mbushur atë deficit demokratik që ishte vënë re në Komunitet. Veç kësaj, Akti Unik i dha një shtysë të fuqishme aftësisë vendimmarrëse të Këshillit të Ministrave. Akti Unik Evropian ka gjithashtu rëndësi jo vetëm për faktin se amandamentoit shumë nga dispozitat e Traktatit të Romës, por edhe se institucionalizoi një formë të re të bashkëpunimit midis vendeve në fushën e politikës së jashtme.

**Banka Evropiane e Investimeve (European Investment Bank):** Banka Evropiane për Investime (EIB), me seli në Luksemburg, ofron kredi dhe garanton të ndihmojë rajonet më pak të zhvilluara të BE-së dhe të bëjë bizneset më të denja për konkurrencë.

**Banka Qendrore Evropiane (ECB)** Banka Qendrore e Evropës, në Frankfurt, përgjigjet për menaxhimin e euros dhe politikës monetare të BE-së (shih Kapitullin 7 'Euroja'). Detyra kryesore e Bankës është të ruajë stabilitetin e çmimeve në zonën e euros. Me Traktatin e Lisbonës, Banka Qendrore ka fituar statusin e Institucionit të BE-së.

**Bashkëpunimi Politik Evropian (European Political Cooperation):** Bashkëpunimi Politik Evropian filloi me anë të takimeve jozyrtare në vitet '70 dhe u formalizua me Aktin Unik Evropian në vitin 1987. Ky bashkëpunim nënkuptonte konsultimet mes shteteve anëtare për çështjet e politikës së jashtme. Shtetet anëtarë merrnin në konsideratë mendimet e Parlamentit Evropian dhe mbanin pozicione të përbashkëta në institucionet ndërkombëtare kur kjo ishte e mundur. Bashkëpunimi Politik Evropian u zëvendësua me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë.

**Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (EMU):** Traktati që institucionalizoi krijimin e Komunitetit Evropian parashikon tre faza për procesin e ngritjes së Bashkimit Ekonomik e Monetar. Faza e parë e BEM e cila filloi në korrik 1990 dhe përfundoi në 31 dhjetor 1993, u karakterizua kryesisht heqja e barrierave të brendshme me qëllim lëvizjen e lirë të kapitaleve brenda Bashkimit Evropian. Faza e dytë filloi në 1 janar 1994. Pikat më të rëndësishme të kësaj faze midis të tjerash janë krijimi i Institutit Monetar Evropian (IME), ndalimi i financimeve të sektorit publik nga bankat qendrore si dhe shmangia e deficiteve të thella në financat publike. Faza e tretë nisi në 1 janar 1999 me transferimin e kompetencave monetare tek Eurosistemi, me

kurset e parevokueshme të këmbimit midis monedhave të vendeve pjesëmarrëse në BE dhe futjen e Euros.

**Bashkimi Evropian (European Union)** u themelua në vitin 1992 nga Traktati i Maastrichtit si një organizatë e bazuar në paraardhësin e tij, Komunitetin Evropian. Bashkimi Evropian përbëhet nga tre shtylla kryesore. Shtylla e parë, e quajtur edhe Komuniteti Evropian, përfshin të gjitha politikat dhe fushat në të cilat Komuniteti Evropian gëzon kompetenca. Vendimmarrja në këto fusha bëhet sipas praktikës komunitare. Ndërsa dy shtyllat e tjera, Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (shtylla e dytë) dhe Çështjet e Brendshme dhe Drejtësia (shtylla e tretë) janë kryesisht forume të bashkëpunimit të thelluar ndër-qeveritar. Megjithatë, me traktatin e Amsterdimit disa nga fushat e gjendura në shtyllën e tretë janë transferuar në shtyllën e parë.

**Coreper-i (Coreper):** Ky është akronimi në frëngjisht për Komitetin e Përfaqësuesve të Përhershëm. Ky institucion përbëhet nga Përfaqësuesit e Përhershëm (Ambasadorët) të shteteve anëtarë dhe është përgjegjës për ndihmën që i duhet dhënë Këshillit të BE-së për kryerjen e punës gjatë fazës paraprake. Ai është një institucion mjaft i rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes pasi është në të njëjtën kohë një forum për bisedime (mes Përfaqësuesve të Përhershëm dhe midis tyre dhe shteteve përkatës) dhe një organ që ushtron kontroll politik duke formuluar direktiva të përgjithshme dhe duke kontrolluar punën e grupeve të punës. Coreper-i vetë është i ndarë në dy pjesë: *Coreper 1*, i përbërë nga Zëvendës-Përfaqësuesit e Përhershëm, dhe *Coreper 2*, i përbërë nga Përfaqësuesit e Përhershëm.

**e-Europe** është iniciativa e cila u lancua nga Komisioni Evropian në dhjetor të vitit 1999 dhe u aprovua nga Këshilli evropian i Lisbonës në mars të vitit 2000. Komunikata që u adoptua menjëherë pas aprovimit u quajt "eEurope - Shoqëri e informacionit për të gjithë" dhe është pjesë e asaj që njihet si strategjia e Lisbonës. Kjo strategji ka si qëllim që Bashkimi Evropian të bëhet ekonomia e njohurive më konkurruese dhe më dinamike në botë Brenda vitit

2010. Objektivat kryesore të kësaj iniciative janë:

- Të sjellë çdo qytetar, shtëpi dhe shkollë, çdo biznes dhe administratë në epokën e digjitalit dhe të komunikimit online;
- Të krijojë një Evropë të edukuar me konceptin e digjitalit, të mbështetur nga një kulturë e hapur për të rejtat e teknologjisë së informacionit;
- Të sigurojë që shoqëria e informacionit është shoqërisht gjithëpërfshirëse.

**Energjia (Energy):** Lëndët djegëse fosile – nafta, gazi natyral dhe thëngjilli – sigurojnë 80 % të energjisë që konsumohet në BE. Një proporcion i madh dhe gjithnjë në rritje i këtyre lëndëve djegëse fosile, importohet në BE nga jashtë. Aktualisht, 50 % e gazit dhe naftës importohen, dhe kjo varësi mund të shtohet në 70 % deri në vitin 2030. Prandaj, BE-ja do të jetë më e ndejshme në zvogëlimin e furnizimit ose rritjen e çmimeve të shkaktuara nga kriza ndërkombëtare. Edhe një arsye tjetër për zvogëlimin e konsumimit të lëndëve djegëse fosile është të ndërrojnë drejtimin e procesit të ngrohjes globale. Në të ardhmen do të duhet të merren hapa të ndryshme, siç janë kursimi i energjisë me përdorimin më inteligjent të saj, me zhvillimin e burimeve alternative të energjisë (sidomos burimet e energjisë ripërtëritëse në Evropë), dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. Energjia ripërtëritëse në Evropë fokusohet në fuqinë e diellit, të erës, në biomasë dhe në fuqinë nukleare. Janë realizuar edhe projekte eksperimentale për zhvillimin e zënies dhe deponimit të CO<sub>2</sub>, si dhe projekte të cilat mundësojnë realizueshmërinë komerciale të automjeteve që përdorin hidrogenin si lëndë djegëse. BE-ja ka

investuar rreth 1.6 miliardë euro për projektin 'qielli i pastër' për prodhimin e aeroplanëve me ndotje më të vogël.

**Europoli (Europol):** Në Traktatin e Amsterdimit, Europoli (Zyra e Policisë Evropiane) përkufizohet si një mjet që ofron një siguri të lartë për të gjithë qytetarët në një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Konventa e themelimit të Europolit u firmos në korrik 1995 dhe hyri në fuqi më 1 tetor 1998. Ajo mbulonte fusha si trafiku i drogës, rrjetet e emigracionit të paligjshëm, trafiku i mjeteve të vjedhura, trafiku i qenieve njerëzore, fallsifikimi i parave dhe mjeteve të tjera të pagesës, trafiku i lëndëve radioaktive dhe nukleare, terrorizmi dhe pastrimi i parave. Traktati i Amsterdimit i shtoi kompetenca të reja Europolit si: bashkërendimi dhe zbatimi i hetimeve specifike të drejtuar nga autoritetet e shteteve anëtarë, zhvillimi i ekspertizës së specializuar për të ndihmuar autoritete vendore në luftën kundër krimit dhe lidhja e marrëdhënieve me prokurorë dhe hetues të specializuar në luftën kundër krimit. Në dhjetor të vitit 2001, fusha e veprimit e Europolit u shtri në të gjitha fushat e lidhura me krimin ndërkombëtar.

**Eurosistemi** përfshin Bankën Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore kombëtare të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat kanë adoptuar monedhën euro në fazën e tretë të krijimit të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

**Fondet Strukturore dhe Fondi i Kohezionit (Structural Funds and Cohesion Fund):** Fondet Strukturore dhe Fondi i Kohezionit janë pjesë e politikës strukturore komunitare, e cila synon pakësimin e dallimeve në zhvillimin ekonomik mes krahinave dhe shteteve anëtarë të BE-së. Prandaj fondet i shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë objektivit të kohezionit ekonomik dhe social. Buxheti i akorduar për politikë rajonale për periudhën 2014-20 është 325 miliard Euro, Fondet strukturore janë: Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal, Fondi Social Evropian, Fondi Evropian i Drejtimit dhe Garancisë Bujqësore dhe Instrumenti Financiar i Drejtimit të Peshkimit.

**Gjykata e Drejtësisë së Komunitetit Evropian (Court of Justice of the European Union):** Me traktatin e Lisbonës të njohur ndryshe edhe si traktati i reformës së BE-së, Gjykata e Drejtësisë së Komunitetit Evropiane ka ndryshuar emrin e saj në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe përbëhet prej tri organeve gjyqësore : Gjykatën e Drejtësisë, Gjykatën e Shkallës së Parë, e cila me këtë traktat behët Gjykatë e Përgjithshme dhe Gjykatën e Specializuar që për momentin është Tribunali i BE-së për shërbimet civile. Juridiksioni primar i Gjykatës është që të siguroj që interpretimi dhe aplikimi i trakteve është në përputhje me të drejtën, mirëpo me Traktatin e Lisbonës kompetencat janë zgjeruar për të gjitha aktivitetet e BE-së, sidomos në fushën e lirisë, sigurisë, drejtësisë dhe disa aspekte të politikës së jashtme. Gjykata përbëhet nga 28 gjykatës dhe 8 prokurorë të përgjithshëm, të cilët emërohen me mirëkuptim reciprok nga qeveritë e shteteve anëtare pas dëgjimit të një komisioni, i cili ka detyrën të marrë pozicion lidhur me përshtatshmërinë e kandidatëve të propozuar për ushtrimin e detyrave në fjalë. Mandati i tyre zyrtar zgjatë gjashtë vjet, me të drejtë rizgjedhje. Ndryshimet me të rëndësime me Traktatin e Lisbonës janë:

- Terminologjie e ndryshuar.
- Krijimi i një Komiteti për të ndryshuar kandidatet.
- Komiteti Rajonal dhe paditësit jo të priverligjuar marrin të drejtën e padisë për Vendim për anulim.
- Padia për Vendim për mosveprim.

- Futja e një procesi të rregullt ligjor për ndryshimet e statusit dhe rregullores së punës.
- Të dy instancat e ri emëruara përbehen tashmë nga një gjykatës për çdo shtet anëtar, numri i të cilëve nuk përcaktohet në mënyrë të saktë nga Traktati.

**Këshilli i Bashkimit Evropian (Council of the European Union):** Këshilli i Bashkimi Evropian (Këshilli i Ministrave) - është një nga dy institucionet legjislativ të UE-së. Është pjesë e legjislativit i cili korrespondon në përbërjen e tij me një sistem nacional me dy dhoma, ai në kuadrin e këtij sistemi përfaqëson shtetet anëtare dhe përbëhet në vartësi të fushave politike nga ministrat përkatës të qeverive kombëtare. Me traktatin e Lisbonës janë bërë këto ndryshime;

- Zgjerimi i sektorit të vendimeve me shumice të kualifikuar .
- Futja e sistemit me shumice të dyfishte.
- Lejimi i publikut gjatë vendimmarrjes.

Votimi në mazhorancë do të jetë gjithnjë e më i zakonshëm, për dallim prej vendimeve unanime. Sistemi i njohur si 'mazhorancë e dyfishtë' do të hyjë në përdorim në vitin 2014. Vendimet e Këshillit do të duhet të përkrahen 55% nga Shtetet Anëtare, të cilat përfaqësojnë së paku 65% të popullatës në Evropë. Ky sistem u jep vendimeve legjitimitet të dyfishtë. Një zhvillim i ri në suaza të Traktatit të Lisbonës është ajo se Këshilli i Ministrave të Jashtëm udhëhiqet nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë/ Zëvendës Presidenti i Komisionit. Në fushat e tjera si bujqësia, financat dhe energjia, Këshilli do të vazhdojë të udhëhiqet nga ministri i vendit që mban rotacionin e Presidencës gjashtëmujore të BE-së. Kjo do të bëjë sistemin e Presidencës të BE-së më koherent dhe më efektiv.

**Këshilli Evropian** - Këshilli Evropian përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur politikë më me eksperiencë të Shteteve Anëtare - kryeministrat dhe presidentet me fuqi ekzekutive. Këshilli Evropian i jep Bashkimit Evropian drejtimin e vet politik dhe përcakton prioritetet e tij. Sipas Traktatit të Lisbonës, Këshilli Evropian bëhet Institucion i plotë i BE-së dhe roli i tij është i definuar qartë. Është krijuar edhe pozita e re e Presidentit të Këshillit Evropian. Presidenti i Këshillit Evropian zgjidhet nga anëtarët e Këshillit Evropian me mandat 2.5 vjet dhe mund të shërbejë më së shumti pesë vjet. Ai ose ajo udhëheqin mbledhjet e Këshillit, avancojnë punën e Këshillit në mënyrë të vazhdueshme dhe përfaqësojnë BE-në në nivel më të lartë ndërkombëtar. Kështu shënohet ndryshimi nga sistemi paraprak, me të cilin Shtetet Anëtare që mbajnë presidencën gjashtë mujore të BE-së, gjithashtu udhëheqin me Këshillin Evropian. Presidenti i ri i Këshillit Evropian do të bëjë veprimet e BE-së më transparente dhe më të sigurta.

**Komisioni Evropian (European Commission):** është institucion i pavarur politikisht nga qeveritë e shteteve anëtare. Roli i tij kryesor është të përfaqësoj dhe të mbështes interesat e BE-së në përgjithësi. Komisioni harton propozim -ligje të cilat i paraqet në Parlament dhe në Këshill. Është organ ekzekutiv i UE-se dhe njëkohësisht është përgjegjës për implementimin e vendimeve të Parlamentit dhe Këshillit.[14] Me Traktati e Lisbonës janë bërë këto ndryshime: Presidenti i Komisionit Evropian do të zgjidhet nga Parlamenti Evropian, i cili së pari duhet të nominohet nga Këshilli Evropian, pritet zvogëlohet numri i komisioneve nga viti 2014, ku parashihet që numri të reduktohet në dy të tretat e numrit të vendeve anëtare të BE-së dhe njëkohësisht do të aplikohet sistemi me rrotacion ku secili vend do të ketë përfaqësuesin e vet për mandat të caktuar, përveç nëse Këshilli Evropian në ndërkohe vendos me unanimitet

ndryshe. Kryetari i Komisionit me këtë traktat ka fuqi të madhe pasi që i është dhënë e drejta për të shkarkuar komisionarët.

**Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social** - Kur merr vendime në disa fusha politike, Këshilli dhe Komisioni konsultohen me Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social (EESC). Anëtarët e tij përfaqësojnë grupet e ndryshme ekonomike dhe sociale, të cilat kolektivisht përbëjnë 'shoqërinë e organizuar civile', dhe emërohen nga Këshilli për mandat pesë vjeçar.

**Komiteti i Rajoneve (Committee of the Regions):** Komiteti i Rajoneve (CoR) përbëhet prej përfaqësuesve të qeverisë rajonale dhe asaj lokale. Përfaqësuesit e këtij Komiteti i propozojnë shtetet anëtare dhe i emëron Këshilli, me mandat pesë vjeçar. Këshilli dhe Komisioni duhet të konsultojnë Komitetin e Rajoneve lidhur me çështje relevante për rajoneve. Komiteti mund të japë opinione edhe në iniciativë të vet.

**Kriteret e Kopenhagës** - Në vitin 1993, pas kërkesave të vendeve ish komuniste për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Këshilli Evropian përcaktoi tre kriteret që ato duhet t'i plotësojnë, nëse duan të anëtarësohen. Në periudhën e anëtarësimit, anëtarët e rinj duhet të kenë:

- institucione stabile që garantojnë demokraci, sundim të ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave;
- ekonomi funksionale të tregut dhe kapacitet për t'u ballafaquar me presionin e konkurrencës dhe fuqive të tregut përbrenda unionit;
- aftësinë për të marrë përsipër obligimet e anëtarësisë, përfshirë këtu përkrahjen e synimeve të unionit. Ato shtete duhet të kenë administratë publike, të aftë për zbatimin dhe menaxhimin e ligjeve të BE-së në praktikë

**Marrëveshja e Shengenit** - Në qershor të vitit 1985, pesë nga 10 shtetet anëtare nënshkruajtën Marrëveshjen Shengen, me të cilën forcat policore nacionale të këtyre shteteve iu rrekën punës së përbashkët. Me këtë marrëveshje u përcaktua edhe politika e përbashkët e azilit dhe vizave, gjë që mundësoi heqjen e plotë të kontrollit të njerëzve në kufijtë midis shteteve të Shengenit. Sot, zona e Shengenit përbëhet nga 25 shtete të Evropës, ku përfshihen tre vende që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian (Islandë, Norvegji dhe Zvicër).

**Mjedisi (Environment):** Qëllimi i politikës komunitare të mjedisit është ruajtja, mbrojtja dhe rritja e cilësisë së mjedisit dhe mbrojtja e shëndetit të njerëzve. Ajo gjithashtu synon një shfrytëzim të kujdesshëm dhe të zgjuar të burimeve tokësore. Në të njëjtën kohë, kjo politikë kërkon të promovojë masa në nivelin ndërkombëtar për t'u marrë me problemet botërore të mjedisit. Traktati i Amsterdimit ka shtuar parimin e "mjedisit të qëndrueshëm" si një nga objektivat e BE-së, kurse kërkesave për mbrojtjen e mjedisit i është dhënë më shumë peshë në politika të tjera komunitare, sidomos në kontekstin e tregut të brendshëm. Politika mjedisore është e bazuar në parimet e kryerjes së veprimeve parandaluese, zhdukjes së problemeve mjedisore që në burim dhe pagesës nga ana e ndotësit.

**Ombudsman-i Evropian (European Ombudsman):** Ombudsmani Evropian emërohet nga Parlamenti Evropian pas çdo zgjedhjeje dhe ka mandat aq sa edhe vetë Parlamenti. Ai gëzon të drejtën të pranojë ankime nga çdo qytetar i BE-së ose nga çdo person fizik ose juridik me qëndrim në një shtet anëtar lidhur me rastet e keqadministrimit të veprimtarive të

institucioneve ose organeve komunitare (me përjashtim të Gjykatës së BE-së dhe Gjykatës së Shkallës së parë).

**Parlamenti Evropian (European Parliament):** Parlamenti Evropian është institucion i cili përfaqëson interesat e qytetarëve, fuqia legjislativë e parlamentit evropian është rritur, pasi që ushtron funksione legjislativë dhe buxhetore së bashku me Këshillin, do të ushtrroj funksione këshillëdhënëse dhe të kontrollit demokratike, duke përfshirë edhe zgjedhjen e Kryetarit të Komisionit. Sipas Traktatit të Lisbonës, Parlamenti Evropian ka 750 anëtar të cilët zgjedhën sipas sistemit të proporcionalitetit, me së paku gjashtë vende dhe me se shumti 96 vende të lejuara për një vend anëtar. Ndikimi i parlamentit sidomos është zgjeruar në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, në një pjesë të madhe edhe në politikat agrare, parlamentit po ashtu i është dhënë e drejta për inicimin e rishikimit të traktateve, mirëpo sigurisht se pjesa më e rëndësishme sa i përket parlamentit është zgjerimi i rolit të tij në bashkë-ligjvënien me Këshillin. Përmirësohet e drejta për tu shprehur e parlamenteve kombëtare në procesin e ligjvënies evropiane. Ato duhet të informohen në kohë lidhur me proceset ligjvënëse, e më pas mund të pozicionohen në lidhje me to. Nëse një shumicë e parlamenteve kombëtare shprehet kundër një procesi të caktuar, ky kthehet mbrapsht nga Komisioni Evropian.

**Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë/Zëvendës Presidenti i Komisionit:** Me Traktatin e Lisbonës u krijua pozita e re e udhëheqjes së politikës së përbashkët të BE-së për punë të jashtme, politika e sigurisë dhe politika e përbashkët e mbrojtjes. Emërimi i Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, i cili është njëkohësisht edhe Zëvendës Presidenti i Komisionit, është një post i ri në BE. Ky post kombinohet me dy pozita të mëparshme: Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të përbashkët të Punëve të Jashtme dhe Sigurisë dhe Komisioneri për Marrëdhënie të Jashtme. Ai ose ajo emërohen nga Këshilli Evropian. Personi i zgjedhur udhëheq me Këshillin e Ministrave ë Punëve të Jashtme dhe njëkohësisht mban pozitën e Zëvendës Presidentit të Komisionit Evropian. Ai ose ajo jep propozime, zbaton politikën e jashtme në emër të Këshillit dhe përfaqëson qëndrimet e Bashkimit Evropian në nivel ndërkombëtar. Kjo pozitë është paraparë të ndihmojë BE-në që të mbrojë më mirë interesat dhe vlerat e veta në skenën ndërkombëtare dhe të shprehet njëzëshëm

**Politika e Përbashkët Bujqësore (Common Agricultural Policy):** Politika e Përbashkët Bujqësore (PPB) është një çështje ekskluzivisht brenda kompetencave komunitare. Qëllimi i kësaj politike është siguri i çmimeve të arsyeshme për konsumatorët evropianë dhe e të ardhurave të drejta për fermerët, kryesisht duke themeluar organizata të tregut të përbashkët bujqësor dhe duke aplikuar parimet e çmimeve të vetme, solidaritetit financiar dhe preferencave komunitare. Politika e Përbashkët Bujqësore është një nga politikat më të rëndësishme komunitare pasi merr 45% të buxhetit të BE-së

**Presidenca e BE-së (Presidency of the Union):** Presidenca e BE-së mbahet nga çdo vend anëtar për një periudhë gjashtë mujore. Suksesit me presidencën është një detyrë dhe kontribut që çdo shtet anëtar bën për mirëfunksionimin e institucioneve të Komunitetit. Sidoqoftë formula e rotacionit së Presidencës ka mangësitë e veta prandaj në Projekt-Kushtetutën Evropiane

parashikohet krijimi i institucionit të Presidentit të Këshillit të BE-së, i cili do merret me mbarëvajtjen e punëve në institucionet evropiane.

**Traktati i Lisbonës (Lisbon Treaty):** Marrëveshja u nënshkrua më 13 dhjetor 2007 në Lisbonë nën Presidencën Portugeze dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009. Kjo pjesë, e cila përmbyll shtjellimin e zhvillimit të BE dhe në të njëjtën kohë përcjell edhe një përmbledhje të bazave juridike aktualisht të vlefshme të BE, ndahet në katër nënkapituj:

Nënkap. 1: Ndryshimet krahasuar me Marrëveshjen e Kushtetutës

Nënkap. 2: Ndryshimet në institucione

Nënkap. 3: Ndryshimet në përcaktimet kushtetuese

Nënkap. 4: Ndryshimet në sektorë të veçantë të politikë

**Traktati i Nicës (Treaty of Nice):** Pranuar në dhjetor 2000, në fund të Këshillit Evropian të Nicës dhe firmosur më 26 shkurt 2001, Traktati i Nicës i dha fund konferencës ndërqeveritare që kishte filluar në shkurt 2000, qëllimi i së cilës ishte rregullimi i punës dhe përbërjes së institucioneve evropiane para ardhjes së anëtarëve të rinj. Pra, ky traktat i hapi rrugë zgjerimit të ardhshëm të BE-së me vende nga Evropa lindore dhe jugore. Ndryshimet kryesore që ky traktat solli janë: kufizimi i madhësisë dhe përbërjes së Komisionit, shtimi i fushave ku aplikohet votimi i shumicës së cilësuar, një shpërndarje e re e peshës së votave në Këshill dhe bërja më fleksibël e marrëveshjeve të bashkëpunimit të përforcuar. Përveç këtyre katër çështjeve kyç, probleme të tjera institucionale u trajtuan: thjeshtëzimi i traktateve, përkufizimi i fuqive, integrimi i Kartës së të Drejtave Themelore dhe roli i parlamenteve kombëtare. Deklarata mbi të Ardhen e Bashkimit, e cila iu bashkangjiti Traktatit, përcakton hapat e ardhshëm që duhen ndërmarrë për të thelluar reformën institucionale. Pas ratifikimit nga të gjithë shtetet anëtare, Traktati i Nicës hyri në fuqi në 1 janar 2003.

**Traktati i Amsterdimit (Treaty of Amsterdam):** Traktati i Amsterdimit është rezultat i konferencës ndërqeveritare që filloi në samitin e Torinos më 29 mars 1996. Ai u pranua në Këshillin Evropian të Amsterdimit më 16 dhe 17 qershor 1997, u firmos nga ministrat e jashtëm të vendeve anëtare dhe hyri në fuqi në 1 maj 1999 pas ratifikimi nga të gjitha vendet anëtare.

Nga pikëpamja ligjore, Traktati ndryshon dispozita të caktuara të Traktatit të BE-së, Traktateve themelues të Komuniteteve Evropiane dhe disa akteve të tjera. Ky traktat nuk zëvendëson traktatet e mëparshme, përkundrazi qëndron në krah të tyre. Ndryshimet kryesore që solli Traktati i Amsterdimit janë transferimi i disa fushave të Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme nga shtylla e tretë tek shtylla e parë, sjellja e parimit të fleksibilitetit, shtimi i fushave ku aplikohet votimi i shumicës së cilësuar në vend të unanimitetit, shtimi i kompetencave ligjvënese të Parlamentit Evropian, etj.

**Traktati i Maastricht-it (Maastricht Treaty):** I quajtur ndryshe edhe Traktati i Bashkimit Evropian, ky traktat u nënshkrua më 7 shkurt 1992 dhe hyri në fuqi më 1 nëntor 1993. Traktati i Maastricht-it e ndryshoi emrin e Komunitetit Ekonomik Evropian në thjesht "Komuniteti Evropian" dhe në të njëjtën kohë solli forma të reja të bashkëpunimit ndër-qeveritar mes shteteve anëtare në fushat e politikës së jashtme, sigurisë, drejtësisë dhe çështjeve të brendshme. Duke ia shtuar këtë model bashkëpunimi ndër-qeveritar strukturës ekzistuese komunitare, Traktati i Maastricht-it krijoi një strukturë të re me tre shtylla që kanë si karakter ekonomik ashtu edhe politik. Kjo strukturë e re u quajti Bashkimi Evropian.

**Traktati i Parisit (Treaty of Paris):** Emri zyrtar i këtij traktati është Traktati themelues i Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut (KEQÇ). Ky traktat u nënshkrua më 18 prill 1951 në Paris dhe hyri në fuqi më 23 korrik 1952. Me Traktatin e Shkrirjes, Autoriteti i Lartë dhe Komisioni i KEQÇ-it u shkrinë në një Këshill dhe Komision të Komuniteteve Evropian. Vlefshmëria ligjore e këtij Traktati mbaroi më 23 korrik 2002.

**Traktatet e Romës (Treaties of Rome):** Traktati themelues i Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike (Euratom) dhe Traktati themelues i Komunitetit Ekonomik Evropian u nënshkruan në Romë më 25 mars 1957 dhe hynë në fuqi më 1 janar 1958. Në gjuhën e përditshme këto traktate u quajtën thjesht "Traktatet e Romës", ndërsa kur përdoret termi "Traktati i Romës" nënkuptohet vetëm Traktati themelues i Komunitetit Ekonomik Evropian.

**Trojka (Troika):** Trojka përbëhet nga shteti i cili mban Presidencën e Këshillit, nga shteti që e ka mbajtur gjatë gjashtë muajve të mëparshëm dhe shteti i cili do ta mbajë për gjashtë muajt e ardhshëm. Trojka ndihmohet nga Komisioni dhe përfaqëson BE-në marrëdhëniet e jashtme.

**Dalja nga BE-ja-** për dallim nga traktatet paraardhëse, Traktatin e Lisbonës përmban klauzolën e daljes nga BE nëse ndonjë vend anëtar vendos të largohet. Kjo procedurë normalizohet duke obliguar vendin anëtar që të informoi Këshillin Evropian para se të shkëputet anëtarësimi, pastaj Këshilli pas pëlqimit të marrë nga Parlamenti e njofton shtetin anëtar se mund të tërhiqet. Risia e fundit është se Traktati i Lisbonës BE-së i ofron mundësin e krijimit të Zyrës së Prokurorit Evropian, zyrë kjo që do të jetë kompetente që të iniciojë procedurë ligjore ndaj kriminelëve dhe grupeve kriminale në rastet kur dëmtohen interesat financiare të BE-së.